



ÇFARË DËHET TË DINI RRETH KËRKESES PËR AZIL

INFORMACIONI PËR FËMIJËT E PASHOQËRUAR



Përshëndetje! Ne jemi fëmijë nga vende të ndryshme. Ne kemi udhëtuar për një kohë të gjatë përpara se të mbërrinim në Irlandë për të kërkuar mbrojtje. Kemi mbërritur vetëm, pa prindërit tanë.



Përshëndetje. Unë quhem Lisa. Do t'ju shpjegoj ato çfarë duhet të dini në lidhje me kërkesën për azil (quajtur ndryshe edhe mbrojtje ndërkombëtare).

Çfarë është mbrojtja ndërkombëtare?



Nëse një person nuk mund të kthehet në vendin e tij të origjinës për shkak se atje do të ishte në rrezik, ai mund të përfitojë mbrojtje ndërkombëtare dhe të qëndrojë i sigurt në vendin që i ka garantuar këtë mbrojtje.

Kujdestari juaj do t'ju shpjegojë më tej se kush mund të përfitojë mbrojtje ndërkombëtare dhe cila është procedura përkatëse.

Në Evropë, mbrojtja ndërkombëtare njihet gjithashtu me emërtimet azil, status refugjati ose mbrojtje plotësuese. Ndoshta fjala azil nuk është e panjohur për ju. Unë do të përdor fjalën azil kur flas për mbrojtjen ndërkombëtare pasi është më e lehtë për ju që ta mbani mend.

Mos harroni - tani jeni të sigurt.


Në Evropë, të gjithë trajtohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht origjinës, besimit fetar apo ngjyrës së lëkurës.





Në Evropë, të gjithë personat
nën 18 vjeç konsiderohen
fëmijë.

Si fëmijë, ju keni të drejta të
veçanta. Siguria dhe mirëqenia
juaj janë tepër të rëndësishme.



Ju do të takoni nëpunës të ndryshëm, p.sh. stafin e autoriteteve të azilit, siç ilustronet këtu. Ata do t'ju bëjnë pyetje rreth jush dhe udhëtimit tuaj drejt Evropës.

Mos harroni, nëpunësit janë këtu për t'ju mbrojtur dhe për të vendosur se çfarë është më e mira për ju.

Ju mund të ndani gjithmonë me ta mendimet, nevojat dhe ndjesitë tuaja.



Çfarë është një kujdestar?



Për shkak se keni mbërritur këtu pa prindërit tuaj, autoritetet do t'ju caktojnë një të rritur, që njihet si kujdestar, i cili do t'ju ofrojë mbështetje.

Një kujdestar është një person që ndihmon fëmijët që mbërrijnë në Evropë pa prindërit e tyre apo pa një të rritur tjetër përgjegjës për ta.

Kujdestari mund të jetë burrë ose grua. Kujdestarët mund të quhen gjithashtu edhe përfaqësues.

Nëse nuk e keni takuar ende kujdestarin tuaj, do ta takoni atë sa më shpejt që të jetë e mundur.

Ndonjëherë, autoritetet mund t'ju caktojnë fillimisht një kujdestar të përkohshëm që t'ju mbështesë derisa të takoni kujdestarin tuaj të përhershëm.





Roli i kujdestarit është t'ju shpjegojë gjithçka që duhet të dini në lidhje me qëndrimin tuaj dhe t'ju ndihmojë të merrni vendime të rëndësishme. Për shembull, kujdestari do t'ju ndihmojë me paraqitjen e kërkesës për azil, do t'ju shpjegojë procedurat, do t'ju shpjegojë të drejtat dhe detyrimet tuaja, si dhe do të marrë pjesë me ju në takimet me autoritetet.

Ju mund të ndani gjithmonë mendimin tuaj me kujdestarin, t'i bëni pyetje dhe ta informoni nëse keni nevojë për diçka. Ata janë aty për t'ju mbështetur.



Nëse keni ndonjë problem me kujdestarin tuaj, informoni nëpunësit Kjo nuk do të ndikojë negativisht në kërkesën tuaj për azil.



Çfarë ndihme do të ofrohet gjatë procedurës?



një
vendqëndrim i
sigurt



veshmba
thje



gjëra të tjera që
mund t'ju duhen



ushqim



vizita te mjeku



frekuentim i
shkollës



Do të jetoni në një ambient që është i përshtatshëm për ju dhe do të përfitoni ndihmën e nevojshme në varësi të moshës

E paraqita kërkesën për azil. Çfarë do të ndodhë tani?



Së pari, kërkesa duhet të regjistrohet dhe të depozitohet.

Kërkesa juaj do të regjistrohet dhe do të depozitohet në të njëjtën ditë, brenda 10 ditëve nga momenti që keni paraqitur kërkesë për azil.

Më pas duhet ta depozitoni kërkesën tuaj brenda 21 ditëve nga regjistrimi.

Kujdestari juaj ose kujdestari i përkohshëm do t'ju informojë(në) për ditët dhe orarin, dhe kujdestari juaj do t'ju shoqërojë tek autoritetet.

Kujdestari juaj do të qëndrojë me ju gjatë procedurës.



Gjatë regjistrimit dhe depozitimit do të ndodhin sa më poshtë...



Ju do t'u tregoni nëpunësve të gjitha dokumentet e identitetit që keni me vete (pasaportë, kartë identiteti etj.).



Mund t'i nënshtroheni një kontrolli fizik, si dhe kontrollit të sendeve tuaja vetjake. Sendet vetjake mund të mbahen përkohësisht nga autoritetet, por do t'ju kthehen të gjitha, përveç atyre që janë të rrezikshme.



Do të fotografoheni.



Do t'ju merren gjurmët e gishtërinjve.



Mund t'ju
lihet takim me
mjekun



- Një nëpunës do t'ju bëjë pyetje rreth jush dhe familjes suaj në Evropë



Një nëpunës do t'ju kërkojë të jepni të dhënat tuaja të kontaktit (adresën dhe numrin tuaj të telefonit).



Do t'ju bëhen pyetje shtesë rreth:

- jush dhe familjes suaj
- vendit tuaj dhe vendeve ku keni jetuar më parë
- arsyeve përse u larguat nga vendi juaj dhe përse nuk dëshironi të ktheheni
- mënyrës se si keni udhëtuar drejt Irlandë



Mos harroni!

Është shumë e rëndësishme që të flisni me kujdestarin tuaj dhe të bashkëpunoni me autoritetet e azilit.



Ajo që i tregoni kujdestarit ose nëpunësve do të mbetet **konfidenciale**. Kjo do të thotë se informacioni që u jepni atyre nuk do të ndahet asnjëherë me qeverinë e vendit tuaj të origjinës dhe as me njerëzit nga të cilët keni frikë.




A do të qëndroj në Irlandë gjatë procedurës së azilit?



Pas regjistrimit, autoritetet do të vendosin se cili shtet do ta shqyrtojë kërkesën tuaj. Do të jetë ose Irlandë ose një shtet tjetër evropian. Shteti nuk mund të zgjidhet nga ju, por vendimi do të merret duke pasur parasysh interesin tuaj më të lartë. Këtë do t'jua shpjegojnë autoritetet.

Irlandë

**Një shtet
tjetër
evropian**





Është e rëndësishme që gjatë regjistrimit t'u tregoni autoriteteve:

- nëse keni familje në një shtet tjetër evropian
- nëse keni kërkuar azil në një shtet tjetër evropian më parë.

Nëse keni familjarë në Evropë, është e rëndësishme t'i informoni nëpunësit rreth gjithçkaje që dini për ta. Mundet që të qëndroni me ta ose në këtë shtet ose në shtetin ku jetojnë ata.

Nëse nuk e dini se ku ndodhet familja juaj, ose nëse keni humbur kontaktin, mund të kërkonit ndihmën e kujdestarit tuaj për ta gjetur atë.



Çfarë do të ndodhë pas regjistrimit dhe depozitimit?



Pas regjistrimit, ju do të merrni një dokument (të përkohshëm) që deklaron se kërkesa juaj është paraqitur dhe është regjistruar.

Pasi kërkesa juaj të jetë depozituar, ju do të merrni një dokument që deklaron se keni paraqitur kërkesë për azil. Ky dokument është i rëndësishëm, prandaj ruajeni siç duhet. Mbajeni me vete sa herë që largoheni nga vendi ku po qëndroni ose kur keni një takim me autoritetet. Mund ta ruani në telefonin tuaj, nëse keni një të tillë.



Si do ta kuptojnë nëpunësit moshën time?




Nëse nuk keni dokumente për të vërtetuar moshën tuaj dhe nëse autoritetet kanë dyshime në lidhje me moshën tuaj, stafi i autoriteteve të azilit mund t'ju kërkojë të bëheni pjesë e një vlerësimi të moshës. Ky është një ushtrim që ndihmon në llogaritjen e moshës.

Vlerësimi i moshës bëhet në mënyra të ndryshme.

Për shembull, ajo mund të bazohet në dokumentet që keni paraqitur ose në intervistat me nëpunësit ose specialistë të ndryshëm. Nëse ka dyshime të mëtejshme, mund t'ju kërkohet t'ju bëhet një ekzaminim mjekësor. Në këtë rast, do të kërkohet pëlqimi juaj dhe i kujdestarit tuaj.

Nëse në bazë të vlerësimit të moshës dilet në përfundimin se ju jeni mbi 18 vjeç, ju do të konsideroheni të rritur. Në këtë rast, do të merrni më shumë informacion.





Nëse autoritetet kanë përshtypjen se dikush ju ka lënduar, ata do t'ju propozojnë të vizitoheni te një mjek.

Rëzultatet e kontrollit mjekësor do të merren parasysh gjatë shqyrtimit të kërkesës suaj.




Pas depozitimit të kërkesës suaj, mund t'ju bëhen një ose disa intervista personale.

Kjo do të thotë që një nëpunës do t'ju bëjë pyetje të tjera rreth jush, rreth arsyeve përse u larguat nga vendi juaj dhe rreth arsyeve se përse nuk dëshironi të ktheheni. Nëse autoritetet ju kërkojnë të merrni pjesë në një intervistë, duhet të merrni pjesë në të dhe t'u tregoni atyre gjithçka që mund të mbani mend. Intervista personale do t'i nënshtrohet regjistrimit zanor.

Kujdestari juaj do t'ju informojë se kur dhe ku do të zhvillohet intervista dhe do t'ju mbështesë gjatë saj.



Po nëse nuk e kuptoj gjuhën e nëpunësve?



Nëse nuk e kuptoni anglisht, një përkthyes që mund të flasë gjuhën tuaj do t'ju ndihmojë të kuptoni.

Roli i vetëm i përkthyesit në rastin tuaj është përkthimi i bisedës. Ajo që i tregoni nëpunësit të ngarkuar me trajtimin e rastit dhe përkthyesit do të mbetet konfidenciale.

Në varësi të se si ndiheni më rehat, mund të kërkonti që intervistuesi ose përkthyesi juaj të jetë grua ose burrë. Një zgjedhje e tillë do të mundësohet nëse është e disponueshme. Tregojini kujdestarit nëse preferoni një grua ose një burrë sa më shpejt të jetë e mundur dhe para intervistës.




Sa kohë zgjat në total?



Pas intervistës, gjithçka që shpjeguat do të shqyrtohet.

Nga dita e depozitimit, mund t'ju duhet të prisni deri në **6 muaj** deri në dhënien e një vendimi. Ndonjëherë, mund të zgjasë më shumë, por nuk duhet të tejkalojë **21 muaj**. Pritja mund të jetë e vështirë, por tregohuni të duruar. Autoritetet duan të marrin vendimin e duhur për rastin tuaj.

Ju mund t'i drejtoheni gjithmonë kujdestarit tuaj nëse keni nevojë për ndihmë për të përballuar periudhën e pritjes.




Një mik tha se autoritetet nuk do ta shqyrtojnë kërkesën e tij për azil. Përse kështu?



Autoritetet fillimisht verifikojnë nëse është e nevojshme ta shqyrtojnë një kërkesë për azil ose jo.

Autoritetet mund të mos e shqyrtojnë plotësisht kërkesën tuaj nëse juve ju është dhënë tashmë mbrojtje në një shtet tjetër ose nëse vini nga një shtet që ata e konsiderojnë të sigurt.



Çfarë vendimi do të më jepet?



Autoritetet e azilit do të vendosin nëse keni nevojë për azil apo nëse ka opsione të tjera për ju.

Vendimi do t'ju shpjegohet.



Nëse ju jepet një vendim negativ dhe nëse ju ose kujdestari juaj nuk jeni dakord me të, mund ta dërgoni vendimin në gjykatë dhe ta kundërshtoni. Kjo procedurë quhet apelim.



Si mund të marr më shumë informacion rreth procedurës së azilit?



Përveç kujdestarit tuaj, ka edhe këshilltarë ligjorë që mund t'ju shpjegojnë procedurën e azilit dhe të drejtat e detyrimit tuaja.

Pyesni kujdestarin tuaj për mënyrën se si mund të kontaktoni me ta.



Nëse dëshironi t'ju ndihmojë një avokat, flisni me kujdestarin tuaj ose me një nëpunës tjetër.





Avokati, së bashku me kujdestarin tuaj, mund t'ju ndihmojnë që:



të përgatiteni për intervistën me autoritetet.



të bisedoni me nëpunësit e azilit



të kuptoni vendimin lidhur me kërkesën tuaj për azil dhe të apeloni, nëse ju ose kujdestari juaj nuk jeni dakord me vendimin.



Ju mund të kontaktoni gjithashtu UNHCR-në në çdo kohë gjatë procedurës suaj të azilit.

UNHCR-ja mbështet dhe mbron azilkërkuesit dhe refugjatët.

Njerëzit që punojnë për UNHCR-në ofrojnë informacion dhe ndihmë për azilkërkuesit.

Mund të gjeni informacion të mëtejshëm në adresën <https://help.unhcr.org/>.



UNHCR
The UN Refugee Agency

Si mund të kërkoj ndihmë nëse nuk ndihem mirë ose nëse jam shpesh i shqetësuar?



Tregojini kujdestarit tuaj, një nëpunësi ose stafit që punon në vendin ku po qëndroni nëse:



Ju ka lënduar ndokush



Ndiheni të trishtuar, të zemëruar, të frikësuar ose e keni të vështirë të flini



Keni ndonjë vështirësi tjetër, si aftësi të kufizuara apo sëmundje ose nëse jeni shtatzënë

Në këto raste, do të merrni ndihmë

A kam ndonjë detyrim?



Po

**Ju duhet të ndiqni ligjet
dhe rregullat e këtij shteti.**

Nëse keni dyshime në lidhje
me rregullat ose ligjet,
pyesni kujdestarin tuaj.

**Ju duhet të qëndroni në
vendin ku kujdestari juaj ju
ka thënë të qëndroni.**

Autoritetet kanë zgjedhur
një vend për ju. Mos ikni
dhe mos u largoni Irlandë
pa lejen e autoriteteve.

**Ju duhet të bashkëpunoni
me nëpunësit.**

Kur kërkohet, ju duhet t'u
përgjigjeni pyetjeve që ju
bëjnë dhe të ndiqni
udhëzimet e tyre.



Jini të singertë dhe tregojuni autoriteteve gjithçka që dini kur ju bëjnë pyetje.

Ajo që thoni është shumë e rëndësishme për kërkesën tuaj.

Mund të mos mbani mend gjithçka dhe mund të mos jeni në gjendje t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve. Nëse nuk mbani mend shpjegojeni këtë dhe mos jepni përgjigje të menduara aty për aty.

Ju duhet të merrni pjesë në të gjitha takimet me autoritetet.

Këto takime janë tepër të rëndësishme. Ju duhet të paraqiteni në ditën dhe në orarin e caktuar.





Ju duhet të jepni të dhënat e sakta të kontaktit.

Për t'u siguruar që të merrni të gjitha informacionet dhe programin e takimeve, duhet t'u jepni autoriteteve një adresë ose numër telefoni. Ky informacion do të merret edhe nga kujdestari i cili mund t'ju kujtojë kështu për takimet tuaja. Nëse detajet tuaja të kontaktit ndryshojnë, njoftoni kujdestarin dhe stafin e autoriteteve të azilit. Është e rëndësishme që ata të mund t'ju kontaktojnë.

Ju duhet t'u dorëzoni autoriteteve të gjitha dokumentet që dispononi.

Jepuni atyre të gjitha dokumentet e disponueshme që lidhen me ju, si dhe arsyet për të cilat jeni larguar nga vendi juaj. Kjo përfshin dokumentet e identitetit (pasaportën), certifikatën e lindjes ose të arsimit të kryer, dokumentet mjekësore ose dokumente të tjera.

Ju duhet të jepni të gjitha informacionet dhe dokumentet sa më shpejt që të jetë e mundur.

Nëse nuk i keni dokumentet në këtë moment, mund t'i jepni më vonë. Bisedoni me kujdestarin tuaj. Kujdestari juaj mund të jetë në gjendje t'ju ndihmojë që t'i siguron këto dokumente dhe t'ua jepni ato në kohë autoriteteve.

Nëse nuk mund t'i përmbushni detyrimet tuaja, njoftoni menjëherë kujdestarin tuaj dhe stafin e zyrës së azilit dhe shpjegojuni arsyen.



Çfarë ndodh nëse nuk i përmbush detyrimet e mia?



Mospërmbushja e detyrimeve tuaja mund të ndikojë negativisht te kërkesa juaj.

Ju mund të humbni disa nga të drejtat dhe shërbimet mbështetëse që shpjegova.



Procedura juaj e azilit mund të ndërpritet ose të refuzohet nëse nuk i përmbushni detyrimet tuaja, për shembull nëse:

- nuk u përgjigjeni pyetjeve të autoriteteve, ose
- nuk i lejoni ata t'ju marrin shenjat e gishtërinjve, ose
- largoheni pa leje nga vendi ku po qëndroni.

Në raste të tilla, autoritetet do të mendojnë se ju nuk jeni serioz në lidhje me kërkesën tuaj. Ju nuk do të konsideroheni më një kërkues dhe do të humbni të gjithë mbështetjen e ofruar.





Nëse nuk u tregoni autoriteteve të vërtetën për veten apo historinë tuaj ose nëse fshihni informacione të rëndësishme ose shkatërroni qëllimisht dokumentet tuaja, kërkesa juaj mund të refuzohet dhe mund të mos ju jepet azil.

Nëse autoritetet zbulojnë më vonë se nuk keni thënë të vërtetën gjatë procedurës së azilit, mund t'ju hiqet e drejta e azilit.





Ju shpjegova gjërat më të rëndësishme që duhet të dini. Kujdestari juaj dhe autoritetet do t'ju japin shpjegime të mëtejshme gjatë procedurës së azilit.





**Mos harroni!
Kërkesa për azil
është pa pagesë**






Tregohuni të kujdesshëm

Kini kujdes nga njerëzit që ju ofrojnë ndihmë në këmbim të favoreve apo parave. Ata mund të kenë qëllime të këqija.




Dikush mund t'ju inkurajojë të përpiqeni të largoheni. Mos harroni se nuk duhet të largoheni, pasi kjo mund të jetë e rrezikshme për ju.






Tregojini menjëherë kujdestarit tuaj ose të rriturve që punojnë në vendin ku po qëndroni, nëse dikush po përpiqet t'ju bindë të bëni diçka që ju nuk dëshironi ose diçka që duket e gabuar.



**Si duhet të veproj nëse
dua të kthehem në vendin
tim dhe ta ndërpres
procedurën e kërkesës
sime?**



Nëse dëshironi të ktheheni në vendin tuaj dhe të ndaloni procedurën e kërkesës suaj, njoftoni kujdestarin tuaj dhe autoritetet. Ata mund t'ju ndihmojnë të ktheheni në mënyrë të sigurt.



Nëse keni pyetje të mëtejshme në lidhje me atë që sapo shpjegova, pyesni kujdestarin tuaj, autoritetet ose stafin që punon në vendin ku po qëndroni.



An Roinn Dlí agus Cirt,
Gnóthaí Baile agus Imirce
Department of Justice,
Home Affairs and Migration

Kjo broshurë është vetëm për qëllime informuese. Ajo nuk krijon në vetvete të drejta apo detyrime. Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA) ka siguruar strukturën kryesore të këtij materiali dhe riprodhimi dhe ndryshimi i kësaj broshure autorizohet nga EUAA-ja vetëm për shtetet anëtare të BE-së. EUAA-ja nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi apo detyrim për saktësinë, përmbajtjen, plotësinë, ligjshmërinë ose besueshmërinë e informacionit të përfshirë në këtë faqe nga shtetet anëtare të BE-së ose nga ndonjë palë tjetër e tretë përgjegjëse. EUAA-ja dhe çdokush që vepron në emër të EUAA-së nuk mbajnë përgjegjësi për përdorimin që mund t'u bëhet informacioneve që përmban kjo broshurë.

© Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin, 2025